

Z. Francesco Florit

Z. Francesco Florit ka diplomuar për Drejtësi në Universitetin e Triestes në vitin 1988 ku është dekoruar me vendin e parë për disertacionin e tij mbi të drejtën e tatimeve dhe të drejtën tregtare. Ai ka përfunduar një vit studime në Universitetin e Drejtësisë në Edinburg mbi Gjykatat Britanike, sistemin e të drejtës penale dhe sistemin e të drejtës zakonore në kuadër të Projektit për Juristët e Rinj Evropian në vitin 1998. Ai e kreu provimin e jurisprudencës më 1990 dhe punoi si avokat në sektorin e të drejtës së punës. Pas studimeve të mëtejshme dyvjeçare, ai e kaloi me sukses edhe provimin për t'u bërë gjykatës në vitin 1992.

Si gjykatës ai u mor me çështjet e të drejtës civile dhe penale për të specializuar më pas në të drejtën penale. Ai punoi si Gjykatës Ndërkombëtar me UNTAET në Timorin Lindor dhe në Panelin Special për Krime të Rënda prej vitit 2002 – 2005 ku i ka shqyrtuar rastet e krimeve të rënda kundër njerëzimit të kryera nga Armata Indoneziane.

Ai është dërguar nga Qeveria e Italisë në Misionin për Sundimin e Ligjit EULEX (Komponenti i Drejtësisë) në mars 2008. Që nga fillimi i funksionimit më 9 dhjetor 2008 ai ka punuar si Gjykatës Ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke u marrë me rastet më të rënda të veprave penale.

Z. Florit është emëruar anëtar i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga Shefi i Misionit më 4 Mars 2010.